



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 24
Prishtinë, më 25 nëntor 2013, në orën 10:00, sala S-II
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Adem Grabovci, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Imri Ahmeti, Bali Muharremaj.

I ftuar: Lars Lage Olofsson, auditor i përgjithshëm, Dardan Gashi, ministër Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri, koordinatore e Komisionit, Mehmet Simnica zyrtar i fushës në Komision dhe Saranda Kelmendi, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.11.2013;
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri, miratoi rendin e ditës pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 13.11.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi njëzëri, pa vërejtje, procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 13 nëntor 2013.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012

Kryetari – Opinioni i auditimit për vitin 2012 për MMPH, është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Theksimi i çështjes është dhënë për shkak se pasuritë fikse nuk janë të besueshme sipas raportit të auditimit. Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2011 të MMPH-së, kanë rezultuar në 12(dymbëdhjetë) rekomandime kryesore, këtu përfshihen edhe 2 (dy) rekomandimet kryesore në raportin e auditimit menaxherial për Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK). Në fund të auditimit për vitin 2012, është konstatuar se nga rekomandimet e vitit të kaluar, 2 rekomandime janë adresuar plotësisht, 8 pjesërisht dhe 2 rekomandime nuk janë adresuar ende. Gjatë vitit 2012, Qeveria me vendimin e saj, ka shkurtuar buxhetin fillestar për 5,159,564€. Kjo për arsye të kursimit të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, përkatësisht shpronësimet. Derisa kishte realizuar 83% të buxhetit final, respektivisht 76% të buxhetit fillestar. Në këtë nën shpenzim të buxhetit, kishte ndikuar reduktimi i mjeteve të tepruara për shpronësimin e pronave, respektivisht vonesat në realizimin e projekteve. Po ashtu, një konstatim jo i mirë i ZAP-it është edhe në fushën e prokurimit publik, ku janë konstatuar 8 të gjetura, për të cilat janë dhënë edhe rekomandimet.

Pyeti: Sa MMPH është duke aplikuar në kuadër të dikastereve të veta, aplikimin e GPS për veturat, kur dihet se një nga të gjeturat e auditorit është shfrytëzimi i veturave të MMPH-së nga zyrtarët dhe mungesa e një regjistri të plotë për këtë.

Ramiz Lladrovci – Opinioni i auditimit për vitin 2012 për MMPH-në, është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes. Sipas kësaj, del se nuk ka pasur shkelje materiale. E rëndësishme është edhe diskutimi lidhur me të gjeturat e auditorit për çështjen e menaxhimit të mbetjeve medicinale, e dalë kjo nga raporti i auditimit të Ministrisë së Shëndetësisë. MMPH-ja ka bërë shumë të arritura në konteste të pastrimit të ambientit, si dhe rrënimin e objekteve pa leje tash së fundi në fshatin turistik Prevallë. Unë personalisht, e inkurajoj ministrin Gashi në punën që ka bërë në këtë drejtim.

Albert Kinolli– Pyeti : *Pagesa e avancës pa mbulesë të sigurimit*- Bashkëfinancimi nga MMPH për rregullimin e shtratit të lumit Mirusha në Gjilan, ishte 650,000€. Ministria ka paguar avancën ndaj operatorit ekonomik (OE), në vlerë prej 469,976€. Derisa OE kishte siguruar avancën në kompaninë e sigurimeve vetëm në vlerë prej 47,000€. Po ashtu, një e gjetur tjetër ka të bëjë me anashkalimin e kriterëve gjatë vlerësimit, sepse në tri raste të ndryshme të prokurimit, nuk ishte aplikuar kriteri administrativ i kërkuar në dosje të tenderit. Në dy raste është fjala për vërtetimin e lëshuar nga ATK-ja për pagesën e rregullt të tatimit. Ndërsa, në një rast, certifikata për instrumentet gjeodezike e skaduar.

Afrim Hoti– MMPH-ja ka laramani të financimit, si nga grandit qeveritar, nga të hyrat vetjake si dhe një pjesë nga donacionet. Marrë në përgjithësi, nga ndarja prej 61.7 milionë euro për vitin 2012, MMPH-ja ka shpenzuar 51.1 milionë euro apo rreth 83 % e buxhetit në total, brenda kësaj shume të mjeteve është përfshirë edhe shuma e mjeteve prej 54.7 milionë euro për shpronësim të pronave për nevoja nacionale. Pyeti: Pse ishte ky shpenzim joracional i buxhetit, kishte gabime në planifikim të buxhetit apo kishte pengesa në ekzekutim të buxhetit? Po ashtu, *dobësi në menaxhimin e automjeteve, sipas vendimit të Ministrisë, në rast përdorimi të automjeteve jashtë orarit të punës, shpenzimet e derivateve do t'i bartin vet shfrytëzuesit e*

automjeteve. Evidencat e Ministrisë rreth kësaj, nuk ishin të plota. Në një rast dëmi, i shkaktuar jashtë orarit, ishte riparuar nga Ministria. Këtu kisha kërkuar nga ana e ministrit të MMPH-së për një sqarim më konkret.

Murselj Haljilji– Pyeti: Në raport të auditimit thuhet se ka pasur lidhje të kontratave, të cilat nuk ishin paraparë në plan të prokurimit, dëshiroj të di se për çfarë kontratash është fjala?

Po ashtu, në një rast tejkalmi të pagesave, *tek kontrata për mirëmbajtje dhe servisim të fotokopjeve dhe printerëve në vlerë 10,000€, ishin ekzekutuar pagesa në vlerë 12,214€.* Kontrata e njëjtë përdoret edhe nga AKK-ja. Pagesat shtesë gjithsej ishin në vlerë prej 2,214€. Kërkoj një sqarim më konkret për këtë.

Valbona Dibra– Theksoi se opinionin e auditimit për MMPH-në është opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes, çka d.m.th se PVF-të kanë pasqyruar pamje të drejtë dhe të saktë. Theksimi i çështjes është dhënë për shkak të regjistrimit të pasurisë. Me këtë rast, dëshiroj të falënderoj edhe ZAP-in për hartimin e raporteve të auditimit, sipas specifikave që kanë organizatat buxhetore. Sipas raportit të auditimit, shpenzimet kapitale janë realizuar 82%, ndërsa shpenzimeve në total prej 83%. Në këtë rast, dëshiroj të inkurajoj ministrin për adresimin e të gjeturave nga ana e ZAP-it.

Dardan Gashi, ministër i MMPH-së– Është e vërtetë se ZAP-i ka gjetur disa defekte në auditimin e MMPH-së, për këtë ka dhënë edhe rekomandime. Theksimi i çështjes është dhënë për shkak të stacioneve të monitorimit të arit, të cilat gjenden në pjesën veriore dhe ju e dini situatën e sigurisë që ka mbretëruar në atë pjesë të Kosovës. Një e gjetur tjetër ka të bëjë me mosrealizimin e shumës së mjeteve për shpronësim. Kjo ishte si rezultat i kontesteve pronësore-juridike me tokat e shpronësuar, e jo si rezultat i mos efikasitetit të stafit të MMPH-së. Ne kemi marrë këtë përgjegjësi para dy viteve me një staf vetëm prej 2 personash, tani aktualisht. Një e gjetur tjetër ka pasur të bëjë me avancat e pambyllura. Në fakt, kjo është eliminuar para se të bëhet raporti final i auditimit.

Arben Çitaku, sekretar i MMPH-së – Në raportin e vitit 2013, do të keni pasqyrën e saktë për progresin e arritur në këtë Ministri, lidhur me rekomandimet për këtë raport. Të gjeturat në MMPH, janë trajtuar qysh në nivelin e parë me ZAP-in. *Avanca pa mbulesë*, ka ndodhur për shkak të një lëshimi teknik. MMPH-ja ka një marrëveshje për bashkëpunim me Komunën e Gjilanit. Kontrata nënshkruhet nga Komuna e Gjilanit, ndërsa Ministria vetëm bën pagesën. Ky avancë është dashur që të kërkohej nga Komuna e Gjilanit dhe bashkërisht me lëndën të vijë për pagesë në Ministri. Komuna ka sjellë një sigurim të avancës, që nuk ka mbuluar 100% shumën. Ne kemi reaguar dhe mjetet të cilat janë lëshuar në avancë, pastaj janë siguruar 100%. *Kontratat jashtë planit të prokurimit*- është e pamundur që në një ministri me këtë diversitet kaq të ndërlikuar, të kemi një parashikim të të gjitha kontratave. E rëndësishme është se kontratat e dhëna janë në përputhje me ligjin. Kjo ka pasur të bëjë me aksionin” Ta pastrojmë Kosovën” dhe në bashkëpunim me shoqërinë civile, në pamundësi të subvencioneve, ne kemi qenë të detyruar të bëjmë prokurime për atë ditë. Kjo ka ndikuar në të gjeturën e ZAP-it. Kriteri administrativ në rastet e vlerësimit të kontratave- kemi të bëjmë me rastin e ndryshimit të TVSH-së. ATK-ja ka bërë tani deklarimin e TVSH-së online nëse ka paguar TVSH, ndërsa në dosjen e tenderit ka mbetur si kërkesë ligjore administrative për certifikatë të TVSH-së. *Përdorimi i automjeteve zyrtare*, me inspektoratin në terren është e pamundur që brenda orarit të punës të kthehen të gjitha automjetet. GPS-të janë përdorur në mbi 50% atë automjeteve, pastaj automjetet i kemi të vjetra dhe kemi pasur telashe për instalim e GPS-ve. Për të mundur të racionalizojmë shpenzimet, kemi vendosur që të gjitha shpenzimet nga stafi do faturohen nga stafi. Udhëzimi Administrativ për përdorimin e automjeteve zyrtare, lejon që me vendim të veçantë, Ministri ta lejojë përdorimin e veturës mbas orarit, me kusht që shpenzimet të barten nga zyrtari.

Kryetari – Kjo është në kundërshtim me ligjin, sepse përqindja e avancës është e përcaktuar me ligj dhe kjo është dashur të paguhet me Ministrinë e cila pastaj kontakton me operatorin. Kriteret janë përcaktuar nga Ministria dhe është dashur të respektohen nga Ministria. Dosja e tenderit duhet të jetë e kompletuar, nëse keni pasur atë kriter, është dashur të respektohet. Nëse përdorimi i veturës mbas orarit është bërë për shkak të specifikave në punë, atëherë pse duhet të paguhet derivatet nga stafi? Kjo lë për të kuptuar se ajo veturë përdoret për arsye private. Në një rast, ka pasur defekt dhe e ka paguar Ministria. Planifikimi është bërë nga MMPH, i cili nuk është përmbushur ashtu siç është planifikuar. Planifikimi dorëzohet në fillim të vitit. Ka mungesë të dokumentacionit, ndërsa në 8 raste nuk ka fatura të plota.

Zukë Zuka, ZAP – Avanca, sa i përket përqindjes, është e drejtë. Mirëpo, sigurimi i avancës me ligj, duhet të sigurohet 100%. Lidhur me këtë, nuk është bërë sigurimi 100%. Ministria ka vendim, me të cilin lejon përdorimin e veturave jashtë orarit për nevoja të Ministrisë, por me shpenzime vetjake. Pra, në pyetje është shpenzimi, por jo përdorimi i veturës.

Adem Grabovci – Si anëtar i Komisionit, më intereson sqarimi dhe tërheq vërejtjen nëse ka nevojë edhe auditorit. Le të kërkojë sqarime nëse ka ndodhur një gjendje dhe mos të figurojnë në raport gjëra për të cilat nuk janë të sakta. Pastaj, edhe sekretari do t'i jepte sqarimet e veta dhe jo të involvojnë gjëra, akuza për institucione, pa nevojë. Mos të lejojmë të krijohet një perceptim i gabuar, pa bazë. Kjo po e shkatërron vendin me informata të pasakta. Pyeti auditorin: A është e përcaktuar në mënyrë decitive me UA, çështja e përdorimit të veturave mbas orarit të punës? Nëse diçka është e rregulluar me ligj dhe nuk e ndalon ligji, ajo është e lejuar dhe kjo nuk mund të evidentohet si e gjetur apo shkelje. Pastaj, nëse një ligj nuk është në rregull, atëherë organi legjislativ bën ndryshimin. Kemi rastin e LPP. Në disa raste, e kemi vërejtur që ai ligj po pengon për sukses. Ligjet duhet të jenë rregulla që nuk pengojnë punën, por hapin rrugën për sukses. Është kënaqësi që kemi eliminuar shkeljet e rënda dhe po merremi me këto 9 shkelje të cilat gjithashtu duhet të evitohen.

Ramiz Lladrovci – Kriteret e tenderit - Komisioni vlerësues është dashur ta ketë certifikatën e tatimit, pavarësisht asaj që tashmë kjo vërtetohet online. Kriteret duhet zbatuar. Auditori ka marrë për bazë rregullativën ekzistuese, dhe mbi bazën e saj, ka konstatuar këtë të gjetur.

Zukë Zuka, ZAP– Vendimi për përdorim të veturës mbas orarit të punës është në përputhje me UA, po e gjetura e auditorit ka të bëjë me shpenzimin.

Kryetari – Gjithçka që evidentohet në raportin e ZAP-it, nënkupton që ka shkelje me ligjin. Prandaj, kërkoj mendimin e ZAP-it.

Artan Venhari, zëvendësauditor– Sipas UA, nuk ka ndalesa të tilla nëse ka arsyetim. Por në rastin konkret ka të bëjë më shumë me shpenzime. Pra, shpenzimet është dashur të barten nga shfrytëzuesi i automjetit e jo nga Ministria. Në asnjë moment nuk po themi që është shkelur ligji apo UA. Por, ne kemi evidentuar çështjen e shpenzimeve, joligjshmërinë e vendimit.

Arben Çitaku, sekretar i MMPH-së – Lidhur me laramanin e shpenzimit dhe të shpërndarjes, rreth 80-90% e buxhetit të Ministrisë është e koncentruar në shpronësime në projektet e shtetit për autostrada. Kjo ka ndikuar që të ketë një koncentrik të shpenzimit në shpronësim. Planifikimi i prokurimit është bërë dhe është dorëzuar në KRPP. Për të kryer të gjitha shpronësimet, është e pamundur të përmbushet 100% dhe kjo varet nga shumë faktorë. Ne varem nga aplikacionet, të cilat pronarët e tokave i sjellin nga rregullsia e atij aplikacioni dhe shqyrtimi që duhet t'i bëhet, dhe masën prej 83% të shpenzimit të buxhetit për shpronësime e konsideroj sukses, duke pasur parasysh që ka pasur vetëm 7 zyrtarë.

Në rastet e tjera, që janë 8, janë kryesisht të ndërlidhura me Agjencinë Kadastrale dhe Agjencinë për Mbrotjtjen e Mjedisit.

Rasti për servisimin e fotokopjeve dhe teknologjisë informative nuk tejkalohet mbi 10 mijë euro. Kjo ka qenë një gabim teknik. *Personeli*- LASH ka obliguar ristrukturimin dhe kjo ka qenë e pamundur të kryhet gjatë viti 2012. Ne kemi hartuar organogramin dhe tashmë kjo do të adresohet dhe është eliminuar çështja e ushtruesve të detyrës. Është dashur të pritet miratimi i UA dhe të adresohet kjo çështje për organizimin e brendshëm.

Ilir Morina, Agjencia për Mbrotjtje të Mjedisit – Është bërë fuzionomi i agjencive, në kuadër të Ministrisë dhe në vitin e kaluar drejtorja e parë ka kaluar në këtë agjenci. Në mungesë të stafit, ka pasur mungesë të paraqitjes të të gjitha faturave që janë dhënë lidhur me të hyrat. Me ndihmën e auditorit të brendshëm, është adresuar kjo e gjetur dhe tani në vitin 2013 nuk ekziston kjo e gjetur.

Murat Meha, Agjencia Kadastrale e Kosovës – Agjencia ka vetëm një vërejtje, që ka qenë mungesa e një certifikate të instrumenteve gjeodezike gjatë një tenderimi dhe kjo çështje është zgjidhur në kuadër të OSHP-së. *Buxheti i shfrytëzuar nga AKK* - përpos buxhetit të Kosovës ka edhe donacion nga BB, GIZ, Qeveria e Norvegjisë dhe nga KE. Në të ardhmen, kemi planifikim të vetëfinancimit. Kemi vështirësi në organizimin vertikal, sepse kemi menduar që në të ardhmen mund të jemi të vetëfinancuar ose pjesërisht të vetëfinancuar. Mjetet rreth rilevimit aerofotografik, i kemi shpenzuar rreth 40%, për shkak se ka filluar projekti me vonesë. Në kufirin me Serbinë është penguar dhe kjo do të përfundojë më 30 nëntor të këtij viti.

Ramiz Lladrovci – U interesua rreth të gjeturave të auditorit, përkitazi me Ministrinë e Shëndetësisë që kanë të bëjë me MMPH-në. Është fjala për funksionimin e furrave, të gjetura këto në raportin për menaxhimin e mbeturinave medicinale. Auditori ka konstatuar se me vendimin e MMPH-së është mbyllur furra djegëse, me arsyetimin se nuk i plotëson standardet. Sipas tyre, këto furra janë funksionale. Kërkoi sqarim lidhur me këtë. Sepse, sipas informacioneve tona, mbetjet medicinale zbrazen në mbeturina të zakonshme, duke rrezikuar kështu shëndetin e qytetarëve.

Dardan Gashi, ministër i MMPH-së – MMPH-ja nuk është përgjegjësie e drejtpërdrejtë. Lidhur me mbetjet humane, ju njoftoj se është përpiluar Udhëzimi Administrativ që rregullon këtë çështje. Secili spital rajonal duhet të ketë një implant. MSH dhe MMPH duhet që të kërkojnë një modalitet tjetër të financimit për mënyrën e trajtimit të mbetjeve medicinale.

Arben Çitaku, sekretar i MMPH-së – MMPH-ja, për tre vjet radhazi, ka investuar për implantet për sterilizimin e mbeturinave. Meqenëse janë krijuar parakushtet për spitale që të sterilizojnë këto mbetje ne kemi mbyllura insalatorët - furrat djegëse, sepse kjo është e papranueshme. Mbetet çështje e MSH, sepse kapaciteti i këtyre impianteve tejkalon nevojat e spitaleve dhe mund të pranojë edhe kërkesa të institucioneve shëndetësore private.

Kryetari – Kjo është çështje komplekse. Qysh në start kur ndahen mbeturinat, nuk ka hapësira ku duhet të paketohen, bartja bëhet me traktorë etj. Kërkoj që MMPH të ketë një takim me MSH në mënyrë që të gjenden modalitete të sakta për rregullim të këtij problemi. Po ashtu propozoi që Raporti t'i procedohet mbledhjes plenare për shqyrtim, bashkë me raportin e ministrisë së shëndetësisë, për të kërkuar pastaj plan veprimi.

Valbona Dibra– Ishte kundër propozimit që raporti të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare, kjo me arsyetimin se të gjeturat janë të vogla, jo materiale dhe është e panevojshme një gjë e tillë. Nuk ka një çështje madhore shqetësuese për të pasur vëmendjen e mbledhjes plenare.

Ramiz Lladrovci – Ishte kundër propozimit që raporti të procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare, sepse nuk ka një temë që do të trajtohej në mbledhje plenare.

Kryesuesi konstatoi se lidhur me propozimin e kryetarit të Komisionit për procedimin e raportit për shqyrtim në mbledhje plenare, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, me dy vota për dhe tre vota kundër, nxori këtë

Përfundim

Raporti i auditimit të pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2012, nuk procedohet për shqyrtim në mbledhje plenare.

4. Të ndryshme

a) Mbledhja e radhës

Kryetari - Njoftoi anëtarët e Komisionit se mbledhja e radhës është planifikuar më 4 dhjetor 2013. Në këtë mbledhje do të diskutohet për Projektbuxhetin për vitin 2014-2016 të ZAP-it, si dhe do të bëhet shqyrtimi, para miratimit në parim të Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Lidhur me projektligjin, nga konferenca në Budva, Komisioni ka kërkuar angazhimin e një eksperti nga SIGMA, i cili do të japë komentet e tij, lidhur me këtë projektligj.

Lidhur me shqyrtimin e raporteve të auditimit të AKP-së, propozoi që këto raporte të diskutohen në mbledhjen e datës 10 dhjetor 2013. Për vonesën në shqyrtimin e këtyre raporteve, kryetari ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit se Raporti është renditur për shqyrtim në mbledhjen e planifikuar për këtë muaj.

Mbledhja përfundoi në orën 11:25.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu